



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:094828

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05854215

Ac.nr.2276/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar, Kujtim Pasuli dhe Dardan Kadolli-anëtarë, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit V.P nga Peja, me vendbanim të përkohshëm në K..., R. e Serbisë, të cilin e përfaqëson i autorizuari V.A, avokat në R..., kundër të paditurve R.L nga Peja, të cilin e përfaqëson O.L, avokat në Pejë dhe Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson e autorizuar D.S.-G, avokate në Prishtinë, për shkak të dorëzimit të palujtshmërisë dhe kompensimit të dëmit, vlera e kontestit, 2.700€, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e autorizuar e paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.135/18, të datës 27.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e paditësit V.P nga Peja, me vendbanim të përkohshëm në K..., R. e Serbisë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.135/18, të datës 27.01.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.135/18 i datës 27.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.135/18, të datës 27.01.2021, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET kërkesë padia e paditësit V.P, nga Peja, me vendbanim të përkohshëm në K..., R. e Serbisë, më të cilën ka kërkuar që të: „APROVOHET kërkesë padia e paditësit V.P, nga Peja, me vendbanim të përkohshëm në K..., R. e Serbisë, SI E BAZUAR. OBLIGOHET e paditura-Komuna e Pejës që në emër të shkaktimit të dëmit paditësit t’ia paguaj shumën prej 2.700€. ANULOHET kontrata mbi qiranë e lidhur në mes të paditurës së parë Komuna e Pejës dhe të paditurit të dytë R.L nga Peja, për banesën në lagjen F... Rr. „...” në rrugën „...- kati i ... në sipërfaqe 54 m² banesa nr... OBLIGOHET i padituri i II R.L, ta liroi banesën nga njerëzit dhe sendet e cila gjendet në lagjen F... rruga „...” në rrugën „...- kati i ... në sipërfaqe 54 m² banesa nr... DETYROHET paditura e parë Komuna e Pejës të i kompensoi shpenzimet procedurale dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 105€, dy parashtrës për precizimin e kërkesë padisë në shumë prej 210€ dhe 8 seanca të mbajtura nga për një seancë prej 135€.” SI E PA BAZUAR. OBLIGOHET paditësi V.P, nga Peja, me vendbanim të përkohshëm në K..., R. e Serbisë, që të paditurve: Komuna e Pejës dhe R.L, t’iu paguaj secilit veç e veç shpenzimet gjyqësore dhe atë: të paditurës Komuna e Pejës, shumën prej 914€ dhe të paditurit R.L, shumën prej 1.080, në afatin prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të gjitha arsyeve ligjore, me propozim që të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Te paditurit nuk kanë dhënë përgjigje në ankesën e paditësit, edhe pse të njëjtëve ankesa iu është dorëzuar.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi fillimisht ka ushtruar padi kundër të paditurit të parë për lirim dhe dorëzim të paluajtshmërisë, ndërsa më pas ka zgjeruar padinë në kuptimin subjektiv edhe ndaj të paditurës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin.

Ndërsa në arsyetim ka theksuar se: gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, këtë çështje juridike, pati parasysh të gjitha shkresat-provat, që gjenden në shkresa të lëndës, dhe bëri vlerësimin e tyre, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, dhe arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Duke vërtetuar faktin se paditësi V.P, edhe pse disponon me një kontratë të shitblerjes të vërtetuar kinse në Gjykatën Komunale në Pejë, me shenjën Vr..., të dt..., pra kontratë mbi fitimin e pronësisë në pronën lëndore, nuk e ka fituar këtë të drejtë, ngase nuk e ka provuar pakontestueshëm se në bazë të shitblerjes është bërë pronar siç pretendon, pra, ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirë, sepse me të gjitha provat e administruara është vërtetuar se kjo fare nuk ka ndodhur. Gjykata Themelore në Pejë, vlerëson se nga të gjitha provat e administruara e duke filluar fillimisht nga kontrata e shitblerjes e vërtetuar kinse në Gjykatën Komunale në Pejë, me shenjën Vr..., të dt..., etj. është vërtetuar se paditësi nuk e ka fituar ligjshëm të drejtën e pronësisë në këtë pronë lëndore. Andaj në bazë të provave që ka prezantuar pala paditëse, Gjykata, ka përfunduar se paditësi nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë pasi që as personi juridik që figuron në kontratë, *(që e ka prezantuar vet pala paditëse)*, nuk e ka gëzuar këtë të drejtë të pronësisë, andaj nuk ka pasur mundësi ligjore që këtu paditësit t'ia bartë të njëjtën të drejtë, pra, të cilën nuk e ka pasur, andaj për këto arsye vlerësohen të pa bazuara pretendimet e palës paditëse. Mirëpo, kjo gjykatë, gjithmonë duhet të ketë parasysh se edhe sipas detyrës zyrtare duhet vlerësuar kjo kontratë-me shenjën Vr..., të dt..., dhe pas një vlerësimi të detajuar ka gjetur se e njëjta është e pavërtetëgjegjësisht gjykata ka vërtetuar sipas detyrës zyrtare mos vërtetimin e dokumentit-kontratës lëndore. Për të arritur deri të një përfundim i tillë, gjykata ka kërkuar nga arkivi i gjykatës këtë kontratë, dhe me shkresën-përgjigjen e dorëzuar nga arkivi i Gjykatës Themelore në Pejë, me dt.08.11.2018, e të nënshkruar nga arkivistja e lartë H.Sh, ka vërtetuar se me shenjën Vr..., të dt..., nuk bëhet fjalë për kontratë, por, është në pyetje një deklaratë e personave tjerë (I.K dhe S.K). Andaj gjykata në këtë mënyrë ka vërtetuar pavërtetësinë e kësaj kontrate, pra, ka vërtetuar faktin se kjo kontratë është e falsifikuar, e cila mirët se fare nuk ekziston. Andaj bazuar në të cekurat gjykata refuzoi kërkesën e palës paditëse si të pabazuar. Gjykata gjen se në mes të ndërgjyqësve në veçanti është kontestuese: ekzistimi i kontratës lëndore dhe posedimi i banesës nga paditësi, si dhe fakti se banesa ka qenë e banueshme, etj. Andaj, Gjykata gjatë vendosjes, pati parasysh edhe faktet tjera, që kanë vërtetuar se palët kontraktuese në kontratën e shitblerjes-e më konkretisht pronari i banesës lëndore në cilësinë e shitësit, nuk e ka pas këtë të drejtë as vetë, sepse nuk u prezantua asnjë provë nga pala paditëse, që do të vërtetonte një gjë të tillë*(edhe pse gjykata disa herë është munduar edhe zyrtarisht që të siguroi nga pasardhësi i „E..”, K.E.K dhe K.O.S.T.T, dhe nuk ka siguruar asnjë të dhënë-dokument për ndërtimin e këtyre trafove, që*

sipas palës paditëse i kanë pas në marrëveshje „E.,” dhe Komuna e Pejës atëherë). Nga Gjykata është vlerësuar edhe dëshmia e dëshmitareve V.M dhe Gj.K, të cilat me dëshminë e tyre e kanë vërtetuar faktin se ndërtesa ku gjendet banesa lëndore ka qenë e pa përfunduar, pa dyer, pa dritare, pa rrymë të instaluar, pa ujë, se aty janë vendosur qytetarët që nuk kanë pasur mundësi strehimi, e ku më vonë e paditura e dytë me këta qytetarë-ku hynë dhe i padituri R., kanë lidhur kontratën mbi qiranë me të paditurën e parë-Komunën e Pejës, e cila është pronare e ndërtesës ku gjendet edhe banesa lëndore. Gjykata ka vlerësuar edhe fletë pagesën e dorëzuar si provë, në të cilën cekët se është paguar taksa e jo ndonjë pagesë tjetër siç pretendon pala paditëse. Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e të autorizuarit të palës paditëse se bëhet fjalë për çështje të gjykuar „res judicata”, por këtë pretendim dhe pretendimet e tjera në padi kjo gjykatë nuk i konsideron me ndikim, dhe njëjtat i merr si të pa bazuara për të vendosur ndryshe, nga se Gjykata, rithekson edhe njëherë se në rastin konkret exofficio-sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar kontratën e shitblerjes të vërtetuar kinse në Gjykatën Komunale në Pejë, me shenjën Vr...., të dt...., dhe për të cilën ka vërtetuar pa dyshim, se nuk është e vërtetuar në këtë gjykatë, pasi që me këtë numër-shenjë është e vërtetuar një deklaratë me persona krejt tjerë... Bindja e gjykatës që të vendosë si në dispozitiv është forcuar edhe nga fakti se pala paditëse nuk ka arritur të argumentoi faktet: se është gjegjësisht ka qenë mbajtëse e pasurisë kontestuese-e sendit dhe se është penguar nga të paditurit në posedimin e pasurisë kontestuese, ngase qëndron fakti i kundërt se i padituri R., është posedues sipas kontratës mbi qiranë që e ka lidhur me të paditurën-Komuna e Pejës. Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh faktin(*t’i mbyll sytë para një fakti*) se vërtet paditësi ka një vendim nga HABITAT-I, i cekur më lartë, por, Gjykata gjithashtu në këtë fakt u bë e kujdesshme për arsye se pala paditëse në asnjë moment nuk vërtetoi vërtetësinë e kontratës lëndore(e për pasojë posedimin e saj, gjegjësisht nuk vërtetoi se pronari paraprak i’ a ka dorëzuar në posedim edhe pasurinë kontestues sipas ligjit, pra, t’i ketë realizuar të drejtat ligjore si pronarë, pasi që sikurse dihet këto të drejta janë të drejta subjektive të karakterit absolutë dhe si të tilla gëzojnë mbrojtje juridike dhe duhen argumentuar. Andaj gjykata me provat e administruara dhe bazuar në faktet e vërtetuara ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit nuk është e bazuar, pasi që paditësi nuk arriti që me prova materiale të bazuara në dispozitat ligjore të argumentojë kërkesëpadinë e tij. Vendimi mbi shpenzimet procedurale është i bazuar në dispozitën e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, pasi që të autorizuarit e të paditurve, gjykatës i kanë prezantuar listën e shpenzimeve e që ka të bëjë dhe atë: për të paditurën Komuna e Pejës, shumën prej 914€ për gjashtë seanca të mbajtura shumën prej 810€ dhe për përgjigje në padi shumën prej 104€, e pjesa tjetër është refuzuar si e pa bazuar, ndërsa për të paditurin R.L, shumën prej 1.080, dhe atë për tetë seanca të mbajtura. Nga sa u parashtua më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë me shkelje të dispozitave të nenit 96 par.2 të LPK-së, për shkak se gjykata e shkallës së parë, seancat i ka mbajtur në prezencë të përkthyeses së gjykatës, gjë që vërtetohet nga procesverbalet e nënshkruara edhe nga i autorizuari i paditësit dhe se me rastin e ekspeditimit të aktgjykimit të njëjtit iu ka dorëzuar edhe aktgjykimi i përkthyer në gjuhën amtare të palës paditëse.

Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182.2 pika j) të LPK-së, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk i ka mohuar paditësit të drejtën që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182.2 pika n) e LPK-së, për shkak se aktgjykimi nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk do të mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktgjykimit, në të janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe se për faktet nuk ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), dhe neni 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2276/21, me datë 19.06.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v